



BORDI

VENDIM

Nr.88, datë 31.05.2019

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015 QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE.”

Në mbështetje të neneve 7, 16, 19, 23,56 dhe 67 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike“, i ndryshuar; nenit 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, neneve 58, 62; 64 dhe 104 të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendim të ERE nr.186 dt. 10.11.2017, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sha, është anëtar me të drejta të plota e European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E), Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve”,

Konstatohet se:

- OST sh.a me shkresën nr. 2035 Prot., datë 15.03.2019, protokolluar në ERE me nr. 228 Prot, datë 18.03.2019, ka përcjellë për miratim “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve.”
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar me ligjin 8/2018, përkatësisht Nenet 7, 19, 23,56 dhe 67, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE nr.186 dt. 10.11.2017, kapitulli IV në tërësi dhe nenit 64 “Modeli i rrjetit per D-1 Dhe D” në veçanti; nenit 104 të “Modelet Individuale të Rrjetit, modelet e bashkuara të rrjetit dhe Analizat e sigurisë Operative”
- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit.

- Dokumenti i përbërë nga 24 nene me kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenaret, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRR dhe MPRr, blloqet baze të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015, dhe merr parasysh sigurinë operationale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonal duke siguruar trajtim të drejtë dhe jo-diskriminues të pjesëmarrësve të tregut si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E) dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të dhe interkoneksionet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që t'a përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve.”.
1. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI